



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1217/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Zejnepe Osmani kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radha e AAK-LDD-së në Viti, paraqitur kundër Xhelal Ramadani kryesues, për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Zejnepe Osmanit, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Viti, nga radha e koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (AAK-LDD) .

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:31 nga kandidatja për anëtare të kuvendit komunal Zejnepe Osmani, ku ka pretenduar se janë bërë manipulime në këto qendra te vendvotimit nr:2609D, 2609D/01R, 02Rdhe03D, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesë nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidates për anëtare të kuvendit komunal Zejnepe Osmani nga radha e AAK-LDD-së, janë të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindse pasi qe ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1217/2013 më datën 06.12.2013.



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.